



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 47/2021 (JR)
Datë 23.08.2021

Vendim nr. 36 (JR)
Datë 24.11.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ardian Hajdari	Anëtar
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 24.11.2021, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 47/2021, datë 23.08.2021, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Galanxhi (Pappa), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 421, datë 13.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si dhe neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Galanxhi (Pappa), me hyrjen në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, ushtronte detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt rivlerësimi me shortin e hedhur më datë 15.01.2019.
2. Nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), menjëherë, pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.
3. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezultoi se më datë 29.01.2019, Komisioni nisi komunikimin me subjektin e rivlerësimit, e njohu me faktin se pas pranimit të kërkesës për dorëheqje nga trupa gjykuese të komisioneres F. Sh., ajo u zëvendësua me komisioneren E. Ç., si dhe i kërkoi subjektit të shprehet nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
4. Më datë 04.02.2019, subjekti i rivlerësimit i njoftoi Komisionit nëpërmjet postës elektronike, kërkesën për përjashtimin e anëtares së trupit gjykues, komisioneres E. Ç., për arsye se ishte pjesë e trupit gjykues në procesin e rivlerësimit të një subjekti tjetër rivlerësimi, z. A. M., kunatit të subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Galanxhi (Pappa). Trupi gjykues i shortuar¹ i Komisionit, me vendimin e datës 21.4.2020, vendosi mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e komisioneres E. Ç. nga shqyrtimi i mëtejshëm i çështjes, me arsyetimin se nuk ndodhej përpara përmbushjes së kërkesave të nenit 30, germa “g” e Kodit të Procedurave Administrative dhe nuk krijoi bindjen se ndodhej përpara kushteve të një njëanshmërie apo bindjeje parajgykuese të komisioneres ndaj çështjes.
5. Komisioni, më datë 09.04.2021, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kontrollin e figurës dhe po në këtë datë njoftoi subjektin në rrugë elektronike për rezultatet e hetimit administrativ, të drejtën për t’u njohur me dokumentacionin e dosjes, si dhe për t’u pajisur me një kopje të tyre, të drejtën për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve dhe marrjen e provave, si dhe përcaktimin e afatit deri më datë 26.04.2021 për dhënien e shpjegimeve lidhur me rezultatet e hetimit.

¹ Trupi gjykues i shortuar me vendimin nr. {***}, datë 10.04.2020, të Komisionit.

6. Nga aktet e dosjes gjyqësore, rezulton se më datë 22.04.2021, subjekti i rivlerësimit i parashtron Komisionit në rrugë elektronike kërkesën për zgjatjen e afatit për dorëzimin shpjegimeve dhe provave mbi rezultatet e hetimit me të paktën një muaj, për shkak të raportit voluminoz të Komisionit dhe të pamundësisë objektive për të dorëzuar dokumentacionin në afatin e përcaktuar. Më datë 23.04.2021, Komisioni njoftoi subjektin për shtyrjen e afatit deri më datë 10.05.2021, si afat i mjaftueshëm për përgatitjen e shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit dhe mbledhjen e provave.
7. Më datë 07.05.2021, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin se ka paraqitur disa kërkesa të reja për marrje dokumentacioni të nevojshëm për kthimin e përgjigjeve, lidhur me barrën e provës dhe kërkoi zgjatjen e afatit për të dorëzuar shpjegimet e rezultateve të hetimit me të paktën një muaj. Komisioni, më datë 10.05.2021, njoftoi subjektin në rrugë elektronike për dhënien e një kohe shtesë deri më 17.05.2021, duke e konsideruar këtë afat më se të mjaftueshëm për t'i kthyer përgjigje Komisionit, pasi kërkesat e reja të bëra nga subjekti i rivlerësimit ishin trajtuar në vazhdimësi përgjatë hetimit dhe korrespondencës me subjektin për më shumë se 2 vjet. Në këtë komunikim, Komisioni i bën me dije subjektit të drejtën që të japë shpjegime e të paraqesë prova deri ditën e seancës dëgjimore, përfshirë dhe vetë seancën.
8. Subjekti i rivlerësimit, më datë 17.05.2021, paraqiti në Komision në rrugë elektronike prapësimet për të vërtetuar të kundërtën e barrës së provës, si dhe kërkesën për çeljen e hetimit administrativ për administrimin e provave të tjera bashkëlidhur prapësimeve, si dhe çeljen e hetimit administrativ për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Komisioni, më datë 18.5.2021, ftoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore më 21.5.2021, ora 14:30, si dhe e njoftoi se nëse shpjegimet e dhëna dhe provat e depozituara do të vlerësohen bindëse dhe të mjaftueshme, Komisioni do të procedojë me marrjen e vendimit për çeljen e hetimit administrativ edhe për kriterin e aftësive profesionale.
9. Në datën 20.05.2021, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin në rrugë elektronike lidhur me pamundësinë për t'u paraqitur në seancën dëgjimore të datës 21.5.2021, për faktin se ishte diagnostikuar me Covid-19, dhe kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore.
10. Komisioni, më datë 24.05.2021, njoftoi subjektin e rivlerësimit me anë të postës elektronike se, për shkak të situatës së tij shëndetësore, seanca dëgjimore e planifikuar për t'u zhvilluar në datën 21.5.2021, do të shtyhej më datë 7.6.2021, ora 9:45.
11. Subjekti i rivlerësimit, në datën 01.06.2021, ka depozituar në Komision kërkesën për miratimin e dorëheqjes² drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim "KLP"), anëtarëve të tij dhe për dijëni Komisionit, me anë të së cilës kërkon miratimin e dorëheqjes nga detyra e prokurorit.
12. Subjekti i rivlerësimit, më datë 03.06.2021, me anë të postës elektronike, i ka kërkuar Komisionit të bëjë *pezullimin e procesit të rivlerësimit dhe shtyrjen e seancës dëgjimore* pasi ka paraqitur pranë KLP-së, më 01.06.2021, kërkesën për mbarimin e statusit të magjistratit dhe dorëheqjen nga detyra si prokurore dhe ishte në pritje të vendimmarrjes për deklarimin e mbarimit të statusit. Po nëpërmjet kësaj kërkesë, subjekti i rivlerësimit i njofton Komisionit se *heq dorë nga e drejta për të marrë pjesë në seancën dëgjimore që do të njoftohet në të ardhmen*

² Administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 01.06.2021.

nga Komisioni për përfundimin e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes dhe deklaronte se nuk do të marrë pjesë në këtë seancë dëgjimore.

13. Komisioni po më datë 03.06.2021, nëpërmjet postës elektronike i konfirmoi subjektit të rivlerësimit marrjen e kërkesës për dorëheqje nga statusi i magjistratit dhe pezullimin e procesit të rivlerësimit, duke e informuar se për të vijuar me vendimin për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, duhet paraprakisht të ezaurohen këta hapa: a) të marrë formë të prerë vendimi i KLP-së; b) Komisioni më pas fton subjektin në seancë dëgjimore, që të deklarojë dorëheqjen ose deklarimin me anë të postës elektronike, se nuk dëshiron të marrë pjesë në seancë dëgjimore, duke shprehur vullnetin e pavesuar për dorëheqje nga procesi i rivlerësimit; dhe c) pasi të ezaurohen këta hapa, trupi gjykues merr vendimin për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.
14. KLP-ja, më datë 22.6.2021, i përcjell³ Komisionit vendimin nr. {***}, datë 18.06.2021, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 22.6.2021. Me këtë vendim, KLP-ja vendosi *deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak dorëheqjeje, për znj. Anila Galanxhi (Pappa), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Dorëheqja jep efekt më datë 31.07.2021.*
15. Komisioni, më 02.7.2021, ka kërkuar informacion⁴ nga KLP-ja dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë nëse ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Galanxhi (Pappa). KLP⁵-ja ka informuar se deri më datë 08.07.2021, subjekti nuk kishte paraqitur ankim ndaj këtij vendimi. Gjykata Administrative e Apelit⁶ gjithashtu ka konfirmuar se deri më 6.07.2021 nuk është bërë ankim ndaj vendimit nr. {***}, datë 18.6.2021, të KLP-së nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Galanxhi (Pappa).
16. Nga aktet në dosjen gjyqësore, rezulton se Komisioni, më datë 12.07.2021, ka ftuar subjektin në seancë dëgjimore, objekt i së cilës do të ishte përfundimi i procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit G, paragrafët 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit, më datë 13.07.2021, njoftoi se heq dorë nga e drejta për të marrë pjesë në seancën dëgjimore, duke rikonfirmuar se nuk dëshiron të marrë pjesë në këtë seancë.

I. VENDIMI I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

17. Komisioni, pasi ka administruar vendimin nr. {***}, datë 18.06.2021, të KLP-së “Për mbarimin e statusit të magjistratit” për shkak të dorëheqjes së znj. Anila Galanxhi Pappa, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ndaj të cilit subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, ka marrë vendimin nr. 421, datë 13.07.2021, mbështetur në nenin “G” të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke vendosur të *deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Anila Galanxhi (Pappa); ndalimin e emërimit të saj, si gjyqtar ose*

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 22.06.2021.

⁴ Me shkresat nr. {***} prot. dhe nr. {***} prot., datë 02.07.2021.

⁵ Me shkresën nr. {***} prot., datë 08.07.2021.

⁶ Me shkresën nr. {***} prot., datë 7.7.2021.

prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

II. SHKAQET E ANKIMIT

18. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 421, datë 13.07.2021, të Komisionit, duke kërkuar shfuqizimin e pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe ankimi:

18.1. Parashikimi në pikën 2 të dispozitivit të vendimit, për ndalimin e subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar për një periudhë 15-vjeçare si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, vjen në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi trupi gjykues i Komisionit nuk kalon testin e pavarësisë dhe paanësisë, për arsye se dy anëtarë të tij nuk plotësojnë kriteret e zgjedhshmërisë të parashikuar nga neni C, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016.

18.2. Parashikimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës, edhe pse i miratuar në Kushtetutë, nuk është proporcional dhe nuk mund të zbatohet *apriori* duke paragjykuar faktin e dorëheqjes. Kjo masë ndëshkimore ka karakter më ndëshkues se çdo dënim tjetër plotësues i parashikuar nga Kodi Penal dhe nga ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

18.3. Dorëheqja nga detyra nuk vjen për shkak të shmangies nga procesi i rivlerësimit, por vjen si pasojë e një situatë të mbartur nga shkelje të rënda ligjore përzgjedhëse të anëtarëve të trupit gjykues, duke krijuar një situatë shqetësuese e stresuese subjektit të rivlerësimit e duke cenuar të drejtën themelore të cilësisë së jetës familjare, parashikuar nga neni 8 i KEDNj-së.

III. VLERËSIMI I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

19. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), më datë 24.11.2021, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 47/2021, datë 23.08.2021, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Galanxhi (Pappa), kundër vendimit nr. 421, datë 13.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

Në çështjen objekt shqyrtimi, Kolegji vlerëson se nuk ndodhet në asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin⁷ 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, që do të legjitimonte kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, pasi subjekti, me ankimin, nuk ka paraqitur prova të reja, si dhe nga analizimi i akteve të administruara në dosje, nuk rezulton që Komisioni të ketë marrë vendimin bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendje faktike të konstatuar

⁷ Neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 parashikon: “1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi, është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë.

gabimisht ose në mënyrë jo të plotë. Kolegji konstaton se Komisioni ka ftuar dy herë subjektin për të marrë pjesë në seancën dëgjimore të datës 21.05.2021, e cila u vendos të zhvillohet më datë 07.06.2021 dhe së fundmi, më datë 12.07.2021, e ka ftuar subjektin e rivlerësimit të shprehë vullnetin nëse do të marrë pjesë në seancë dëgjimore, objekt i së cilës do të ishte përfundimi i procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit G, paragrafët 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit, më datë 13.07.2021, njoftoi se heq dorë nga e drejta për të marrë pjesë në seancën dëgjimore, njoftuar dhe më parë në kërkesën e datës 03.06.2021.

20. Nga analizimi i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankimin e paraqitur, Kolegji konstaton se pretendimin për cenim të parimeve për një proces të rregullt ligjor, të parashikuara nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të sanksionuar në nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës, gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk e lidh me shkelje të kryera nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, të tilla si të drejtën për t'u njohur me aktet e dosjes gjyqësore, për të parashtruar me shkrim pretendimet, me të drejtën për t'u mbrojtur apo të drejtën për t'u dëgjuar etj., por ua atribuon dyshimeve mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e Komisionit, pasi, sipas subjektit të rivlerësimit, dy nga komisioneret e trupit gjykues që kanë shqyrtuar çështjen e tij, nuk plotësojnë kriteret e zgjedhshmërisë të parashikuara nga neni C, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016.
21. Këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit e mbështet në argumentet se: i) mandati i kufizuar i anëtarëve të organeve të rivlerësimit minon pavarësinë e tyre, për më tepër kur nuk ka një shprehje të qartë të pandryshshmërisë së tyre dhe se mund të shkarkohen nga Kolegji në përputhje me nenin 17 të ligjit nr. 84/2016 në rast të një procedimi disiplinor *sui generis* të nisur prej anëtarëve të tjerë ose ONM⁸-së; ii) nuk janë zbatuar kërkesat e rrepta të përzgjedhjes së dy anëtarëve të trupit gjykues, siç është specifikuar në paragrafin 300 të vendimit të GjEDNj-së në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, konkretisht sa i përket eksperiencës dhe vjetërsisë në punë për komisioneret E. Ç. dhe B. B.
22. Në analizë të sa pretenduar, *së pari* Kolegji vlerëson se përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [KEDNj], në drejtim të garantimit të pavarësisë dhe paansësisë, i është nënshtruar analizës së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, certifikuar në fillim të procesit nga Komisioni i Venecias, më pas ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017 [paragrafët 38 dhe 67⁹] dhe së fundmi është konfirmuar edhe nga shqyrtimi nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GjEDNj] në vendimin që i përket çështjes *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*¹⁰. Në këtë të fundit, GjEDNj-ja nuk konstatoi shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, lidhur me mënyrën e krijimit dhe funksionimit të Komisionit dhe Kolegjit. Në paragrafët 284, 288 dhe 317 të këtij vendimi, GjEDNj-ja ka konstatuar se mënyra e funksionimit të institucioneve të rivlerësimit dhe elementet e paansësisë së trupit gjykues të Komisionit përmbushin standardet e KEDNj-së.

Nga analizimi i vendimit të GjEDNj-së në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, në paragrafin 297 të vendimit, kjo gjykatë u shpreh se *kohëzgjatja e caktuar e mandatit të anëtarëve të*

⁸ Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

⁹ http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

¹⁰ <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-208053%22%5D%7D>

organeve të rivlerësimit, nuk përbën asnjë problem, ndërsa në paragrafin 298 shprehet se [...]Mungesa e parashikimit zyrtar të mosheqjes nga detyra të gjyqtarëve në ligjin nr. 84/2016, nuk nënkupton në vetvete mungesën e pavarësisë, përderisa ajo të njihet në gjendje faktike dhe të ekzistojnë garancitë e tjera të nevojshme (shih Sacilor-Lormines, cituar më lart, 67). Mund të shihet nga vetë dispozitat e ligjit nr. 84/2016 se me të vërtetë ky është rasti. As pushteti legjislativ dhe as ai ekzekutiv nuk mund të kërkojnë dorëheqjen ose largimin nga detyra të anëtarëve të organeve të vetingut. Neni 17 i ligjit nr. 84/2016 përcakton rastet specifike kur ata mund të hiqen nga detyra [...]. Fakti që anëtarët e institucioneve të rivlerësimit mund të hiqen nga detyra vetëm në rast të kryerjes së një shkeljeje disiplinore, në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji, nuk vë në dyshim garancitë e nevojshme për mosheqjen e tyre nga detyra, të cilat janë të pranishme në çështjen në fjalë. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se mandati i kufizuar dhe mungesa e pandryshueshmërisë së tyre për shkak të ndonjë procedimi disiplinor cenon pavarësinë e organeve të rivlerësimit, nuk u gjet i bazuar.

Përpos sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të pambështetur faktin që subjekti i rivlerësimit e ka ngritur pretendimin e mosplotësimit të kriterëve të zgjedhshmërisë së anëtarëve të Komisionit vetëm pasi është njohur me vendimin nr. 421, datë 13.07.2021, të Komisionit objekt shqyrtimi pothuajse dy vjet e gjysmë pasi kishte filluar hetimi administrativ ndaj tij në Komision.

Së dyti, procedurat për verifikimin e plotësimit të kriterëve të përzgjedhjes së anëtarëve të organeve të rivlerësimit, të parashikuara nga neni C, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 6 i ligjit nr. 84/2016, dispozitat kushtetuese dhe ato ligjore, ua kanë ngarkuar institucioneve të tjera, konkretisht Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Avokatit të Popullit, Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe Kuvendit të Shqipërisë [shih nenin C, pikat 6 deri 12 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 7 deri 11 të ligjit nr. 84/2016]. Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kontrolli i plotësimit të kriterëve të zgjedhshmërisë të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, referuar dispozitave kushtetuese dhe ligjore, nuk është kompetencë e Kolegjit.

23. Kolegji i Posaçëm i Apelit, në bazë të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, merr në shqyrtim vendimet e Komisionit të cilat janë ankimuar, duke analizuar vendimin e Komisionit dhe pretendimet e ngritura në ankim, duke verifikuar procedurat e ndjekura nga Komisioni në kuadër të respektimit të parimeve të një procesi të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës dhe në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuptim, objekt i shqyrtimit nga Kolegji do të ishte respektimi i parimeve të një procesi të rregullt ligjor, që konsiston në të drejtën e subjektit për t'u njohur me trupin gjykues, deklarin e mosdodhjes në situatën e konfliktit të interesit me ta, të drejtën për t'u njohur me dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, të drejtën e subjektit për të dhënë shpjegimet e tij mbi konstatimet e Komisionit, të drejtën për t'u dëgjuar, respektimin e procedurave ligjore të ndjekura në rastet e kërkesave për përjashtim anëtarë të trupit gjykues etj.
24. Në rastin objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se procedura e ndjekur nga Komisioni ka qenë në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016 dhe Kodit të Procedurave Administrative, sa i përket së drejtës për t'u njohur me aktet e dosjes gjyqësore, së drejtës për

të paraqitur me shkrim prapësimet, për të depozituar prova, si dhe së drejtës për t'u dëgjuar në kuadër të një procesi të rregullt ligjor.

25. Sa i përket kërkesës së paraqitur në Komision për përjashtimin e komisioneres E. Ç., trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në Komision janë zbatuar procedurat ligjore për shqyrtimin e kërkesës për përjashtim duke vendosur mospranimin e saj.
26. Nga analizimi i pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në kërkesën për përjashtimin e komisioneres E. Ç., trupi gjykues i Kolegjit vëren që subjekti të ketë parashtruar faktin se komisionerja ka qenë pjesë e trupit gjykues që po shqyrtonte procesin e rivlerësimit të kumatit të saj, z. A. M. Ky fakt, sipas subjektit, përbënte shkak për përjashtimin e saj konform nenit 30, germa “g” e Kodit të Procedurave Administrative¹¹.

Në analizë të parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, i cili rregullon çështjen e konfliktit të interesit të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se argumenti i përdorur nga subjekti i rivlerësimit se komisionerja *ka qenë pjesë e trupit gjykues që po shqyrtonte procesin e rivlerësimit të kumatit të saj*, nuk kualifikohet në kushtet e situatës së pengesës ligjore të parashikuara nga neni 30 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, apo të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile. Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të drejtë vendimin e Komisionit të datës 21.04.2021, për mospranimin e kërkesës për përjashtimin e komisioneres E. Ç., të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Galanxhi (Pappa).

27. Nga aktet e dosjes gjyqësore, sa i përket dorëheqjes së subjektit nga statusi i magjistratit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka mbajtur një qëndrim konsekuent lidhur me arsyet e dorëheqjes nga detyra, pasi në kërkesën për miratimin e dorëheqjes të datës 01.06.2021, drejtuar KLP-së, që, sipas subjektit, gjen mbështetje në nenet 64 dhe 65/2/3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti *shprehet se i është krijuar mundësi e re profesionale për një marrëdhënie të re pune në sektorin privat që përfaqëson një stad të ri për jetën e saj profesionale, ka vendosur të hedhë këtë hap*, ku bashkëlidhur kësaj kërkesë, subjekti depozitoi dhe *Kontratë individuale pune, datë 01.06.2021*, për punësimin e saj si drejtore juridike, konsulence ligjore pranë shoqërisë “{***}” ShPK. Ndërkohë, në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se arsyet e dorëheqjes nga procesi i rivlerësimit nuk lidhen me mungesën e vullnetit për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, por si pasojë e një situatë të mbartur nga shkelje të rënda ligjore përzgjedhëse të anëtarëve të trupit gjykues, duke krijuar një situatë shqetësuese e stresuese e duke cenuar të drejtën themelore të cilësisë së jetës familjare.

¹¹ Neni 30, germa “g” e Kodit të Procedurave Administrative parashikon se: “Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur: [...] g) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial ose personat e përmendur në shkronjën “b” të këtij neni kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim”.

28. Në kuadër të këtij procesi, trupi gjykues i Kolegjit konsideron të rëndësishëm faktin e shprehjes së vullnetit të subjektit të rivlerësimit për të mos vijuar me procesin e rivlerësimit, duke mos qenë subjekt për shkak të dorëheqjes nga statusi. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për subjektet e rivlerësimit ndaj të cilëve ka filluar hetimi administrativ dhe ky proces ndërpritet me vullnetin e tyre të shprehur për dorëheqjen nga detyra, sjell për pasojë zbatimin e nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet *nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare*. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson të pambështetur pretendimin e subjektit të rivlerësimit që sanksioni i parashikuar në pikën 2 të dispozitivit të vendimit të Komisionit është joproporcional, me arsyetimin se në rastet e aplikimit të institutit të dorëheqjes, pavarësisht motiveve që çojnë në të, dispozitat kushtetuese parashikojnë vetëm një pasojë, zbatimin e nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, që aplikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga organet e rivlerësimit në rastet e dorëheqjes nga detyra përgjatë procesit të rivlerësimit.
29. Trupi gjykues gjithashtu konsideron të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se zbatimi i nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës ka karakter më ndëshkues dhe tejkalon normat maksimale të dënimeve plotësuese të parashikuara nga Kodi Penal dhe nga ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit, siç është masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, apo në rastin e dorëheqjes nga detyra, ndalimi për t’u emëruar në pozicionet e përcaktuara në nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nuk mbështetet në dispozitat që rregullojnë procesin penal. Në rastet e aplikimit të institutit të dorëheqjes nga detyra nga subjektet e rivlerësimit për të cilët nuk ka përfunduar procesi i rivlerësimit, normat kushtetuese nuk lënë në diskrecion të organeve të rivlerësimit një disponim tjetër, ndryshe nga sa parashikon neni G i Aneksit të Kushtetutës.
30. Sa i përket pretendimit të subjektit se procesi i rivlerësimit në Komision i ka cenuar të drejtën themelore të cilësisë së jetës familjare, të parashikuar nga neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke e detyruar të japë dorëheqjen në mbrojtje të kësaj të drejte, neni 8, paragrafi 2 i KEDNj-së, “E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”, parashikon se: *2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve*. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka parashtruar në ankim argumente, rrethana apo fakte se si i është cenuar e drejta për respektimin e jetës private apo familjare, gjithashtu edhe përgjatë shqyrtimit të vendimit të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit nuk gjeti në asnjë rast shkelje të kësaj natyre të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.

Me referencë në vendimin e çështjes *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, GjEDNj-ja në paragrafin 393 shprehet se: *[...] GjENDj nuk sheh asnjë arsye për të dyshuar se qëllimi i ndjekur nga ligji nr. 84/2016 në përgjithësi, dhe ndërhyrja në çështjen e kërkuar në veçanti, nuk ishte në përputhje me qëllimet e identifikuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve, siç përcaktohet në nenin 8, paragrafi 2 [...], duke arritur në përfundimin që nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës. Në çështjen objekt shqyrtimi, vendimi i Komisionit ka ardhur si pasojë e dorëheqjes*

së subjektit të rivlerësimit nga detyra si prokuror, me dëshirën dhe vullnetin e tij të lirë, dhe konfirmuar me veprime konkludente të punësimit në sektorin privat, e për këtë arsye dhe për sa parashtruar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit për shkelje të së drejtës të parashikuar nga neni 8 i KEDNj-së.

31. Pas analizimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe provave të administruara në dosjen gjyqësore, Kolegji çmon se në kuadër të procesit të rivlerësimit, i rëndësishëm është fakti i evidentimit të shprehjes së vullnetit të subjektit të rivlerësimit për të mos gëzuar më statusin e magjistratit, për shkak të dorëheqjes nga detyra e prokurorit. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, pasi dorëheqja nga detyra e prokurorit ka sjellë si efekt ligjor ndërprerjen e procesit të rivlerësimit e, për pasojë, humbjen e së drejtës për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë, për një periudhë 15-vjeçare.
32. Në përfundim të sa arsyetuar më sipër, Kolegji e gjen të drejtë dhe të bazuar në fakte dhe në ligj vendimin e Komisionit nr. 421, datë 13.07.2021, si dhe përcaktimin e pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi për ndalimin e emërimit të znj. Anila Galanxhi (Pappa) si gjyqtare apo prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor apo e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë apo Prokurore e Përgjithshme për një periudhë 15-vjeçare.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 421, datë 13.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Galanxhi (Pappa).
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 24.11.2021.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi